



## Periodiku AMF

### I. Qeverisja e kompanive të sigurimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në bashkëpunim me Programin e Partnerëve për Stabilitet Financiar (PPFS), organizuan në Tiranë, nga data 12-13 mars, workshop-in rajonal me temë “Për qeverisjen e kompanive të sigurimit”. Ky workshop, u drejtua nga Programi i Partnerëve për Stabilitet Financiar, (Programi PFS) i cili është një projekt rajonal për zhvillimin e sektorit financiar, i bashkëfinancuar nga USAID (Agjensia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara) dhe Instituti i Menaxhimit Lindje - Perëndim (EWMi), një organizatë jo fitimprurëse me qendër në New York.

*Vijon në faqen 2*

### II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

#### II.1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën Janar – Shkurt 2008

Në periudhën Janar – Shkurt 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 956,569 mijë lekë, përkundrejt 799,071 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 19.71% nga viti i kaluar, ku 91.28 % e kësaj rritjeje i takoi tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 8.72 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i përket rritjes së tregjeve, në veçanti, u shënuar një rritje në masën 32.70% të sigurimet e Jetës dhe 18.99% të sigurimet e Jo-Jetës.

*Vijon në faqen 3*

#### II.2 Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2007 u dominua në masën 94.60 % nga transaksionet në instrumentet afatshkurtër (bonot e thesarit) dhe vetëm 5.40 % nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” ka pësuar një rritje prej 2,115.55 milion lekë ose 32.45% nga viti 2006. Ndërsa transaksionet e llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” ka shënuar

një ulje në vlerën 1,214.69 milion lekë ose 69.91 % në krahasim me vitin 2006.

*Vijon në faqen 5*

### III. Pjesëmarrje në seminarin “Mbi reformën në pensione në Shqipëri”

Më datë 3-4 mars 2008, Instituti i Sigurimeve Shoqërore me asistencën e Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore, zhvilloi seminarin “Mbi reformën e pensioneve në Shqipëri”. Tema më e rëndësishme në këtë seminar ishte reforma në sistemin e pensioneve, në kuadër të gjetjes së një formule të përshtatshme për llogaritjen e pensionit si dhe roli i shtetit në përballimin e kostos së ndryshimit të skemës ekzistuese.

*Vijon në faqen 6*

### IV. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### Mbrojtja e konsumatorit

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në faqen zyrtare të tij, njoftoi publikun, se nga data 1 Dhjetor 2007 ka hyrë në funksionim të plotë Rregjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik.

*Vijon në faqen 7*

### V. Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit. (IAIS)

#### I. Parathënie

1. Për të mbrojtur interesat e personave të siguruar, të personave përfutues dhe të ankuesve, është e rëndësishme që shoqëritë e sigurimit të administrohen me koherencë dhe maturi. Për më tepër, është themelore që individët në pozicionet kyçe të mos përbëjnë rrezik për interesat e personave të sipërpërmendur.

*Vijon në faqen 7*

## Në këtë numër:

Qeverisja e kompanive të sigurimit .....	2
Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën Janar – Shkurt 2008 .....	3
Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë .....	5
Pjesëmarrje në seminarin “Mbi reformën në pensione në Shqipëri” .....	6
Mbrojtja e konsumatorit .....	7
Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit. (IAIS) .....	7

## Qeverisja e kompanive të sigurimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në bashkëpunim me Programin e Partnerëve për Stabilitet Financiar (PPFS), organizuan në Tiranë, nga data 12-13 mars, workshop-in rajonal me temë "Për qeverisjen e kompanive të sigurimit."

Ky workshop, u drejtua nga Programi i Partnerëve për Stabilitet Financiar, (Programi PFS) i cili është një projekt rajonal për zhvillimin e sektorit financiar, i bashkëfinancuar nga USAID (Agjensia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara) dhe Instituti i Menaxhimit Lindje - Perëndim (EWMI), një organizatë jo fitimprurëse me qendër në New York. I formuar në 1999 si partneritet publik-privat për të ndihmuar kompletimin e reformave të nevojshme për të krijuar sektorë financiarë privatë që mirëfunksionojnë në tetë vende të Europës Qendrore dhe Lindore, që i janë bashkuar Bashkimit Europian në 2005, mandati rajonal i Programit PFS u zhvendos në Europën Juglindore (SEE).

Workshopi rajonal është pjesë e Programit PFS për mandatin në proces të sektorit financiar rajonal. Aktivitetet e Programit PFS janë interaktive, interdisiplinore dhe bazuar në metodologjinë case-study. Nëpërmjet case-study, lektori demonstron se si praktikantët më të mira dhe standartet ndërkombëtare aplikohen në situata të ndryshme. Qëllimi kryesor i këtij workshop-i, ishte të ndante eksperiencën që lidhet me kornizën rregullatore si dhe eksperiencën praktike në lidhje me qeverisjen e kompanive të sigurimit. Gjithshtu, një qëllim tjetër i workshop-it ishte që të ndihmonte implementimin e praktikave dhe adoptimin e standarteve ndërkombëtare të qeverisjes së tregut të sigurimeve në Shqipëri. Në çdo prezantim u përshkrua korniza rregullatore, çështjet vetrregulluese dhe çështjet praktike në vendin dhe juridiksionin përkatës.

Mesazhi që ky workshop përcolli ishte:

- a. Promovimi dhe shkëmbimi i eksperiencës së ekspertizës në rajon.
- b. Përforcimi i aftësive, me qëllim mbikëqyrjen efektive.

I rëndësishëm ishte edukimi i rregullatorëve shqiptarë të sigurimeve dhe i vendimarrësve të shoqërive të sigurimit në Shqipëri, rreth qeverisjes të kompanive të sigurimit në shtetet e sapoanëtarësuar në Bashkimin Europian. Workshop-i u hap nga fjala përshëndetëse e zj. Elisabeta GJONI, Kryetare e AMF. Ajo theksoi rëndësinë e këtij workshop-i në një kohë kur ka zhvillime të rëndësishme të këtij sektori si: investitorë të huaj kanë hyrë në partneritet me shoqëritë lokale, aktivitetet cross-border ndërmjet vendeve të rajonit po zgjerohen (tre shoqëri shqiptare sigurimesh operojnë në tre vende), struktura të reja të korporatave po krijohen duke çuar në krijimin e një organizate të tipit "grupe" ose "konglomerate". Zj. Gjoni, gjithashtu, nënvizoi se workshop-i do të ndihmojë në rritjen e sensibilizimit të aktorëve në sektorin e sigurimeve: rregullatorëve, shoqërive, institucioneve të specializuara etj. mbi rëndësinë e qeverisjes së shoqërive në drejtim të zhvillimit të sigurtë e afatgjatë të bizneseve të tyre dhe të tregut në përgjithësi, si dhe përfitimeve që rrjedhin si rezultat i aplikimit të praktikave më të mira.

Cikli i prezantimeve është hapur me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për gatitur nga z. Keler Gjika (N/Kryetar i AMF) dhe z. Rinald Guri (Drejtor i Kërkimeve dhe Statistikës).

Z. Keler Gjika, paraqiti një analizë të situatës aktuale të tregut të sigurimeve, si dhe të kornizës ligjore aktuale mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit në Shqipëri.

Më pas, z. Gorazd Podbevsek, menaxher i projektit Socius, Slloveni, prezantoi strukturën e qeverisjes së shoqërive të sigurimit në Slloveni, ndërsa z.Boris Persak, Drejtor i Departamentit të Investigimeve, prezantoi dy shembuj për mashtrimin në sigurime dhe implikimin që kjo sjell në qeverisjen e shoqërive të sigurimit.

Z.Geoffrey Mazullo, Drejtor i Programit të Partnerëve të Stabilitetit Financiar(PPFC), prezantoi rastin e një shoqërie sigurimi suedeze, e cila pati probleme serioze me qeverisjen, gjë që çoi në shpërblime të paautorizuara të ekzekutivëve të saj.

Në fund të ditës së parë, z. Audrius Linartas, N/Kryetar Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Lituani, bëri prezantimin e qeverisjes së shoqërive të sigurimit në Lituani.

Në ditën e dytë të workshop-it, zj. Anna Miernicka, Varshavë, Poloni, prezantoi strukturën e qeverisjes së shoqërive të sigurimit në Poloni, ndërsa z.Pawel Dudziej, specialist për mbrojtjen e konsumatorit pranë Autoritetit të Polonisë, diskutoi dy shembuj lidhur me rregullimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit në Poloni.

Në përfundim të ditës së dytë dhe të fundit të workshop-it, z. Jim Vint, FTI Technology Consulting, Londër, bëri prezantimin e të dhënave mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit dhe dha shembuj për pasojat që jep një qeverisje e dobët.

Në këtë aktivitet, ishin 45 pjesëmarrës, ndër të cilët 22 punonjës të AMF-së, përfaqësues nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, përfaqësues të shoqërive të sigurimit në Shqipëri, përfaqësues nga Agjensia e Sigurimeve të Bosnje Hercegovinës, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare aktive në Shqipëri.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën Janar – Shkurt 2008

Në periudhën Janar–Shkurt 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën 956,569 mijë lekë, përkundrejt 799,071 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 19.71% nga viti i kaluar, ku 91.28% e kësaj rritje i takoi tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 8.72% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i përket rritjes së tregjeve, në veçanti, u shënuar një rritje në masën 32.70% të sigurimet e Jetës dhe 18.99% të sigurimet e Jo – Jetës.

Në periudhën Janar–Shkurt 2008, volumi i primeve nga sigurimi i detyrueshëm u rrit në masën 12.91% (nga të cilat vlen të përmendet pesha që zuri portofoli MTPL në këtë rritje 93.77%), ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 35.50%.

Në këtë periudhë u lidhën 82,020 kontrata sigurimi përkundrejt 66,204 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 74,312 nga 62,319, që i takonin të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL shënoi rritjen më të madhe të numrit të kontratave, me 6,697 kontrata ose në masën 55.84%.


Vlen të përmendet rritja në masën 98.40% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 7,708, nga të cilat sigurimi “Jeta dhe shëndeti në udhëtim” pati një rritje prej 1,535 kontrata (192.36%), duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve, në Janar-Shkurt 2008, ishte rreth 212 milionë lekë ose 19.68% më pak se në Janar-Shkurtin e vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 171 milionë lekë, apo 80.19% të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në potofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 50% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 27% krahasuar me 2 muajorin e parë të vitit 2007.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në muajin Janar (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2007	2008
<b>Periudha Janar - Shkurt</b>		
A) Sigurim i Jetës	41,990	55,721
B) Sigurim i Jo - Jetës	757,081	900,849
<i>nga këto</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	553,279	624,690
b) Sigurimi Vullnetar	203,802	276,159
<b>TOTAL</b>	<b>799,071</b>	<b>956,569</b>

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në muajin Janar 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për muajin Janar 2008 (Jo-Jeta)



## II. Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2007 u dominua në masën 94.60% nga transaksionet në instrumentet afatshkurtër (bonot e thesarit) dhe vetëm 5.40% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).


Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” pësoi një rritje prej 2,115.55 milion lekë ose 32.45% nga viti 2006. Ndërsa transaksionet e llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” shënuan një ulje në vlerën 1,214.69 milion lekë ose 69.91% në krahasim me vitin 2006. Kjo ulje nuk pengoi në rritjen në vlerë absolute të totalit të transaksioneve të llojit B dhe C në krahasim me 2006, rritje kjo që kapi vlerën 900.86 milion lekë ose 10.91%.

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale në (mln lekë)		Ndryshimi (në %)
Periudha Janar - Dhjetor	2006	2007	'07/'06-1
<b>Letra me Vlerë të Qeverisë</b>			
<b>A Blerje në tregun primar</b>	<b>9,561.91</b>	<b>9,183.37</b>	<b>(3.96)</b>
Individë	5,160.45	6,108.82	18.38
Persona juridike	4,401.46	3,074.54	(30.15)
<b>B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b>	<b>6,519.16</b>	<b>8,634.71</b>	<b>32.45</b>
Individë	-	8,419.70	-
Persona juridike	-	215.01	-
<b>C Blerje nga individët para afatit të maturimit</b>	<b>1,737.47</b>	<b>522.78</b>	<b>(69.91)</b>
Individë	-	468.18	-
Persona juridike	-	54.60	-
<b>D Vendosje e bonos si kolateral</b>	<b>34.48</b>	<b>83.46</b>	<b>142.04</b>
Individë	-	49.02	-
Persona juridike	-	34.44	-
<b>E Shlyerje e vlerës nominale në maturim</b>	<b>3,059.02</b>	<b>5,554.98</b>	<b>81.59</b>
Individë	-	4,197.03	-
Persona juridike	-	1,357.95	-


Transaksionet e llojit B dhe C së bashku kapën vlerën 9,157.49 milion lekë për vitin 2007. Përkatësisht ky total përbëhet nga 8,634.71 milion lekë transaksioni i llojit B ose 94.29 % ndaj totalit B dhe C dhe 522.78 milion lekë transaksioni i llojit C ose 5.71% ndaj këtij totali.

Në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2007, transaksioni “Blerje në tregun primar” kapi vlerën 9,183.37 milion lekë, ndërsa transaksioni “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” arriti vlerën 5,554.98 milion lekë.

Grafik: Letra me Vlerë të Qeverisë sipas Llojit të transaksionit



Tabelë : Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2007



\* Transaksionet sipas llojit paraqiten në tabelë

## Pjesëmarrje në seminarin “Mbi reformën në pensione në Shqipëri”

Më datë 3-4 mars 2008, Instituti i Sigurimeve Shoqërore me asistencën e Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore, zhvilloi seminarin “Mbi reformën e pensioneve në Shqipëri.” Në këtë seminar ishin të ftuar për të marrë pjesë edhe përfaqësues të AMF-së. Tema më e rëndësishme në këtë seminar ishte reforma në sistemin e pensioneve, në kuadër të gjetjes së një formule të përshtatshme për llogaritjen e pensionit si dhe roli i shtetit në përbalimin e kostos së ndryshimit të skemës ekzistuese.

Prezantimi i parë u mbajt nga Drejtoresha e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku u pasqyrua një pamje e sistemit shqiptar të pensioneve, kryesisht kolona e parë. Prezantimi u përqendrua në tre llojet e pensioneve të ofruara nga skema e detyrueshme, problemet që konstatohen nga kjo skemë si p.sh, masa e ulët e përfitimit, mungesa e nxitjes për pjesëmarrje, evazioni fiskal, etj. Gjithashtu u prezantua reformat parametrike të vitit 2002 dhe një parashikim për skemën aktuale deri në 2075.

Prezantimi i dytë u mbajt nga Zj. Anita Schwarz, (Ekonomiste e Lartë, Njësia e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore). Ky prezantim pasqyroi eksperiencën ndërkombëtare në reformën e pensioneve dhe koston e kësaj reforme në kuadër të objektivave të një sistemi pensionesh, niveli i përfitimit që duhet ofruar, si duhet ofruar ky përfitim, elementët bazë të tre shtyllave dhe së fundmi zgjidhjet e

ndryshme dhe eksperiencën e vendeve të rajonit në këtë drejtim. Nuk u lanë pa përmendur edhe politikën afatshkurtra dhe afatgjata që duhet të ndërmarrë një vend si Shqipëria në kuadër të një reforme të suksesshme në sistemin e pensioneve.

Prezantime të tjera u mbajtën nga përfaqësues të vendeve të rajonit si Bullgaria, Sllovakia, Polonia dhe Kosova. Këto prezantime u përqendruan në eksperiencën e këtyre vendeve në reformën në sistemin e pensioneve, kryesisht në lidhjen mes kontributeve dhe përfitimeve, krijimin e privilegjeve speciale, profesionale drejt sistemit profesional, ndarjen e elementëve të asistencës sociale prej atyre të sigurimeve shoqërore dhe reformën administrative në sistemin e pensioneve, me qëllim uljen e normës së kontributeve.

Në ditën e dytë u trajtuan çështje të ndryshme, se ku duhet të konsistojë reforma e pensioneve në Shqipëri, hapat që duhet të ndërmarrë një vend si yni dhe sa janë kushtet e përshtatshme për implementimin e kolonës së dytë nga ana e Shqipërisë.

U ngritën tryeza pune me të ftuarit dhe ekspertët ku u diskutuan çështje që kishin të bënin kryesisht me kolonën e parë dhe si duhet ndërhyrë për përmirësimin e saj.

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Mbrojtja e konsumatorit

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në faqen zyrtare të tij, njoftoi publikun, se nga data 1 Dhjetor 2007 ka hyrë në funksionim të plotë Rregjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik. Sipas këtij rregjistri, çdo police ka të printuar në pjesën e sipërme apo të poshtme të saj një kod numrash dhe shifrash me 15 karaktere, që përbën kodin identifikues të raportimit të gjeneruar automatikisht në kohë reale nga serverat e AMF-së.

AMF me qëllim mbrojtjen e konsumatorit njoftoi se, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik, çdo i siguruar mund të verifikojë vlefshmërinë e policës së sigurimit në faqen zyrtare të AMF-së, në adresën <http://www.amf.gov.al/mtpl.asp>

Nëpërmjet njoftimit të bërë në disa nga mediat e shkruara dhe elektronike AMF informoi të

siguruarit, që të njihen me kushtet e kontratës së policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik, të afishuara pranë pikave të shitjes së shoqërive të sigurimit.

Gjithashtu AMF informoi, se pranë tij funksionon njësia për trajtimin e ankesave të të siguruarve. Kjo strukturë do të trajtojë në mënyrë të paanshme, me profesionalizëm dhe brenda afateve të gjitha ankesat që do t'i paraqiten, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi ia kthen për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit çështjen e ankimit.

Çdo person i dëmtuar, i cili pretendon dëmshpërblim nga shoqëritë e sigurimit dhe mbetet i pakënaqur për mënyrën e trajtimit të dëmit, masën e dëmshpërblimit apo refuzimin e saj, pasi ka depozituar një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit trajtuese e dëmit, mund të kontaktojë apo të depozitojë një ankesë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Ky verifikim mund të bëhet vetëm për policat e lëshuara pas datës 1 Dhjetor 2007.

## Standartet mbikëqyrëse për kërkesat e përshtatshmërisë dhe vlerësimi i shoqërive të sigurimit. (IAIS)

### I. Parathënie

1. Për të mbrojtur interesat e policëmbajtësve, është e rëndësishme që shoqëritë e sigurimit të administrohen me koherencë dhe maturi. Për më tepër, është themelore që individët në pozicionet kyçe të mos

përbëjnë rrezik për interesat e personave të sipërpërmendur.

2. Studime në experiencën e shoqërive të sigurimit kanë treguar që një nga arsytet më të rëndësishme të problemeve financiare të cilat



rezultojnë ose gati rezultojnë në falimentimin e shoqërive të sigurimit, mund të jenë probleme me menaxhimin ose probleme me aksionerët si psh paaftësi ose operim jashtë fushës së tyre të ekspertizës, mungesë integriteti, synime konfliktuale, ose dobësi në përbalje me vendimet e papërshtatshme të marra në grup.

3. Për këtë arsye, është e nevojshme vendosja e standarteve për një administrim të përshtatshëm dhe të drejtë nga aksionerët kryesorë dhe funksionarët kyç të shoqërive të sigurimit e gjithashtu për vlerësimin e zbatimit të këtyre standarteve, ose është e nevojshme për kryerjen e kontrolleve nga inspektorët për përmbushjen e tyre.

4. Kryerja e kontrolleve nga inspektorët për përshtatshmërinë dhe drejtësinë administruese të shoqërive të sigurimit, gjithashtu kontribuon në parandalimin e marrjes nën kontroll të këtyre shoqërive nga persona me precedentë penale, duke luajtur kështu një rol në parandalimin e krimeve financiare, si p.sh pastrimi i parave.

5. Ky standart duhet të lexohet së bashku me parimet themelore të sigurimit të IAIS:

o Parimi Nr. 5 Kooperimi i inspektorëve dhe shkëmbimi i informacioneve.

o Parimi Nr. 7 Përshtatshmëria e personave.

o Parimi Nr. 8 Ndryshime në kontrollimin dhe transferimin e portofolit të sigurimit.

o Parimi Nr. 27 Mashtrimi.

## II. Synimet

6. Synimet e këtij standarti janë:

o të bëjë të ditur rreziqet e keqadminstrimit

nga një kontrollim apo ndikim i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm mbi shoqëritë e sigurimit;

o të sigurojë që inspektorët e shoqërive të sigurimit i ushtrojnë detyrat e tyre për të vlerësuar, nëse këto shoqëri po administrohen dhe drejtohen me koherencë dhe me maturi (Fit and proper (verifikimi për administrim të përshtatshëm dhe të drejtë = verifikimi I përshtatshëm));

o të ndihmojë konsultimin dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet inspektorëve mbi shoqëritë e sigurimit dhe mbi individët, në mënyrë që të arrihen qëllimet e sipërpërmendura.

## III. Dispozita të përgjithshme

### Standartet e përgjithshme për të aplikuar kërkesat për përshtatshmëri.

7. Për të promovuar operimin sa më të mençur dhe të matur të shoqërive të sigurimit, standartet për verifikimin e përshtatshmërisë (fit and proper) ose të karakteristikave të tjera të përmenduar në këtë material, duhet të aplikohen te aksionerët kryesorë dhe funksionarët kyç të shoqërive të sigurimit, ashtu siç janë përkufizuar edhe në pjesën tjetër të këtij materiali. Përgjegjësia kryesore për vlerësimin e përshtatshmërisë të funksionarëve kyç bie mbi vetë shoqëritë e sigurimit.

### Standartet e përgjithshme për të kryer kontrollin për përshtatshmëri.

8. Mbikëqyrësit duhet të kryejnë kontrolle të mjaftueshme për të vlerësuar nëse aksionerët dhe funksionarët kyç i plotësojnë kërkesat për përshtatshmëri.



## Sistemi drejtues me një dhe dy nivele.

9. Mbikëqyrësit duhet ta dinë që duke kaluar nga një jurisdiksion në tjetrin, ka ndryshime në strukturën ligjore dhe rregullative përsa u përket funksioneve dhe përgjegjësi të drejtorëve. Në disa jurisdiksione ka një sistem drejtimi me dy nivele që konsiston nga një bord mbikëqyrës, i cili ka si funksion kryesor të kontrollojë bordin administrues. Kjo do të thotë që bordi mbikëqyrës nuk ka një funksion ekzekutiv. Në jurisdiksione të tjera me sistem drejtimi me një nivel, bordi ka përgjegjësi më të shumta. Në këtë rast përshtatshmëria ose prova të tjera kualifikimi duhet t'u aplikohen drejtuesve përsa u përket rolit dhe përgjegjësi të tyre duke marrë parasysh edhe strukturën e bordit.

## IV. Qëllimi i standartit

### Aplikimi më minimal tek aksionerët kryesorë dhe tek funksionarët kyç, përkufizimet.

10. Kërkesat për përshtatshmëri dhe vlerësimi i tyre nga një mbikëqyrës kompetent, duhen të aplikohen të paktën në minimum te aksionerët kryesorë dhe funksionarët kyç, si p.sh anëtarët e bordit, drejtorët dhe administruesit e lartë. Një aksioner kryesor përkufizohet si një person (juridik ose fizik) që në mënyrë direkte apo indirekte, vetëm ose me bashkëpunëtorë, ushtron kontroll mbi shoqërinë e sigurimit.

### Aplikimi tek funksionarët e tjerë

11. Juridiksioni mund t'i imponojë dhe t'i aplikojë këto kërkesa edhe te funksionarët e tjerë, duke përfshirë aktuarin e emëruar, oficerin e zbatimit, agjentët sigurues, kontrolluesit financiarë dhe ruajtësit e thesarit.

## Njohja e parimeve për shoqëritë

12. Ndonjëherë, vetë shoqëritë janë aksionerët kryesorë të shoqërive të sigurimit. Në këto raste, prova dhe vlerësimi për parimin e përshtatshmërisë duhet t'u aplikohen këtyre institucioneve dhe gjithashtu edhe aksionerëve kryesorë e funksionarëve kyç të institucionit në fjalë.

## V. Kërkesat për përshtatshmëri

### Kërkesat e përgjithshme

#### Dallimi midis karakteristikave të nevojshme

13. Në mënyrë që të përmbushin kërkesat për përshtatshmëri, një aksioner kryesor dhe një funksionar kyç duhet të kenë dhe duhet të tregojnë disa karakteristika të nevojshme që t'i lejojnë ata të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqërinë e sigurimeve.

14. Përsa i përket aksionerit kryesor, ai duhet të ketë në një nivel minimal karakteristikat e mëposhtme:

- o integritet i treguar në sjelljet individuale dhe profesionale;
- o saktësi në gjykim;
- o saktësi në çështjet financiare.

15. Përsa i përket funksionarit kyç, ai duhet të ketë në një nivel minimal karakteristikat e mëposhtme:

- o integritet i treguar në sjelljet individuale dhe profesionale;
- o saktësi në gjykim;
- o një nivel të mjaftueshëm njohurish, eksperiencë dhe kualifikime profesionale.

### Interesat që duhen mbrojtur

16. Në përgjithësi, interesat që mbikëqyrësi dhe ligji për inspektoriatin që mundohen të mbrojnë, duke përfshirë këtu edhe interesat e shoqërive të sigurimit, të përfituesve dhe të ankuesve, nuk duhen që në asnjë mënyrë të kërcënohen nga aksioneri kryesor apo funksionari kyç i shoqërisë së sigurimit.

### Pavarësia dhe konfliktet e interesave

17. Pavarësisht nga përgjegjshmëria për të tjerët, shoqëritë e sigurimit, në përshtatje me ligjin vendas, për një administrim sa më të mençur dhe të matur, duhet të kenë masa mbrojtëse të mjaftueshme për të parandaluar një ndikim të paligjshëm mbi funksionarët kyç, përta i përket funksioneve dhe detyrave të tyre në atë shoqëri. Shoqëritë e sigurimit duhet të kenë politika dhe procedura të caktuara për të kontrolluar konfliktet e interesave tek funksionarët kyç.

### Zbatimi i vazhdueshëm; Masat kontrolluese nga shoqëritë e sigurimit.

18. Mbikëqyrësit duhet të kërkojnë që aksionerët kryesorë dhe funksionarët kyç t'i zbatojnë kërkesat për përshtatshmëri në mënyrë të vazhdueshme. Shoqëritë e sigurimit duhet të raportojnë informacionet e rëndësishme të marra për funksionarët kyç edhe pas aplikimit fillestar. Mbikëqyrësit duhet të kërkojnë që këto shoqëri të marrin masat e nevojshme që të sigurohen në mënyrë që kërkesat për përshtatshmëri të zbatohen, duke vendosur kështu standarte të larta të etikës dhe të integritetit, duke promovuar një qeverisje të drejtë të shoqërisë dhe duke mbajtur një nivel të përshtatshëm njohurish, experiencë dhe aftësi për vendimmarrje.

### Zëvendësim i përkohshëm i funksionarëve kyç.

19. Në disa raste mund të ndodhë që një funksionar kyç është i paaftë të kryejë detyrën e caktuar dhe një zëvendësues i tij duhet të emërohet brënda një periudhe të shkurtër kohe. Për të mbrojtur interesat e personave të siguruar, është e nevojshme që inspektori të lejojë që posti i funksionarit të zihet në mënyrë të përkohshme nga një person tjetër, derisa pasardhësi i tij të aprovohet nga mbikëqyrja. Në këto rrethana mbikëqyrësi duhet t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të marrë disa masa të mëtejshme për të mbrojtur personat e siguruar, personat përfitues, dhe ankuesit.

### Kërkesat për integritet

#### Integriteti

20. Provat e sjelljes dhe të veprimeve të një individi, që i është nënshtruar kërkesës për përshtatshmëri, duhet të jenë të një niveli shumë të lartë, në mënyrë që të jepet një përfundim për integritetin e tij. Treguesit e një integriteti individual përfshijnë; aspektin kriminal, financiar, mbikëqyrës dhe aspekte të tjera.

#### Treguesit e një natyre kriminale

21. Treguesit e një natyre kriminale lidhen me sjelljen kriminale. Si parim, individi nuk duhet të ketë precedent penal apo të ketë të dhëna për sjellje dhe veprime të mëparshme të tij, të cilat shkelin ligjet që janë bërë për të mbrojtur individët nga humbja financiare, si p.sh humbja financiare për shkak të mashtrimit, të përvetësimit të pasurisë, të përvetësimit të parave apo mashtrime të tjera.

## Treguesit financiarë

22. Treguesit financiarë japin informacione për sjellje të gabuara me aspekt financiar, veprime jo të sakta në llogaritjet financiare, neglizhencë, ose gjykime të gabuara në vendimmarrje. Treguesit mund të jenë; vështirësi financiare që mund të rezultojnë në ndjekje penale, mospërputhje midis detyrimeve financiare, të ardhurave dhe fondeve, falimentimi individual ose në proces të falimentimit individual, vështirësi financiare, ose falimentimi i një institucioni në të cilin individi ka qenë aksioner kryesor apo funksionar kyç.

## Treguesit mbikëqyrës

23. Treguesit mbikëqyrës japin informacione të mbledhura nga mbikëqyrësit gjatë kryerjes së detyrës. Këta mbikëqyrës mund të jenë edhe autoritete që kanë detyra mbikëqyrëse në sektorë të tjerë të ndryshëm nga sigurimet. Tregues të kësaj natyre mund të jenë: mosdhënia e informacionit autoriteteve publike, paraqitja e deklaratave të pasakta financiare dhe jo vetëm masa ose ndërhyrje të tjera korrigjuese nga autoritetet publike.

## Treguesit e një natyre tjetër

24. Tregues të tjerë mund të japin informacione të rëndësishme në lidhje me provën e përshtatshmërisë të individit në fjalë. Si shembuj mund të jenë; mosmarrëveshjet me punëdhënësit të mëparshëm për sa i përket kryerjes së detyrës ose zbatimit të një kodi sjellje, mosmarrëveshje të cilat kanë rezultuar në vënien e një penalteti sipas Kodit të Punës dhe gjithashtu masa disiplinore të vëna nga shoqatat e tregtisë apo shoqatat profesionale, si p.sh shoqatat e aktuarëve, ekspertëve apo juristëve.

## Kërkesa për një saktësi në gjykim

### Saktësi në gjykim

25. Në lidhje me saktësinë në gjykim, individi duhet të ketë një nivel të caktuar balancimi, arsytimi edhe maturie, të treguar këto cilësi në sjellje dhe në vendimmarrje, sidomos në lidhje me një ushtrim të mëparshëm biznesi. Mund të dilet në përfundimin, që individi ka saktësi në gjykim kur nuk ka të dhëna negative për personin në fjalë p.sh. kur këto lloj të dhënash mungojnë në pyetësonin e përmendur në paragrafët 33 dhe 34.

### Të dhënat inkriminuese

26. Veç kësaj nuk duhet që individi, gjatë një aktiviteti të mëparshëm biznesi, të ketë pasur një precedent apo të ketë të dhëna të një sjellje apo veprimi të tij me natyrë mashtruese, shtypëse apo ndonjë veprim të pahijshëm të një natyre tjetër, ose ndonjë sjellje apo veprim të individit, që ka të bëjë me mënyrën e adminstrimit të biznesit, e cila mund të shikohet si shqetësuese.

### Kërkesat për njohuri dhe eksperiencë nga funksionarët kyç

### Njohuritë dhe eksperiencia

27. Njohuria dhe eksperiencia e individit, që i parashtrohet provës së përshtatshmërisë, duhen të jenë të mjaftueshme për një vendimmarrje dhe adminstrim të mençur dhe të matur të shoqërisë së sigurimeve, të cilat gjithashtu duhen të mbahen në një nivel të caktuar.

## Njohuritë dhe eksperiencat e funksionareve të tjerë si faktor plotësues

28. Për vlerësimin e nivelit të duhur të njohurive dhe të eksperiencës, kualifikimet dhe eksperiencat e funksionareve të tjerë brenda shoqërisë së sigurimit mund të merren parasysh si një faktor plotësues. Megjithatë njohuria dhe eksperiencat e individit duhet gjithsesi të jetë në një nivel minimal të caktuar.

## Fushat e njohurisë dhe të ekspertizës

29. Njohuritë dhe ekspertiza e funksionarëve kyç, brenda shoqërisë së sigurimit, duhet së paku të kenë të bëjnë me:

- o administrimin profesional të një shoqërie;
- o rregullat dhe normat që aplikohen në shoqërinë e sigurimit;
- o produktet dhe tregu i sigurimeve;
- o aspektet financiare dhe aktuale si , financimet, investimet, tregu financiar, parimet e aktuarëve dhe risigurimet;
- o organizimin administrativ, kontrollin e brendshëm, informacionet mbi teknologjinë dhe administrimin e riskut;
- o llogaritjet dhe raportet financiare;
- o marrëveshjet me shoqëritë e agjentëve

## Kohëzgjatja e eksperiencave të mëparshme

30. Bordi, si dhe administrata në tërësi, duhet të përbëhet nga individë me disa vite eksperiencë në administrimin e një shoqërie sigurimi.

Vijon në numrin tjetër ...

***Për këtë numër punuan:***  
E. Shehi, R. Guri, E. Kokona,  
R. Eltari, L. Lloji, E. Sherri

